



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-74082, dt. 27 shtator 2024

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Sali (Shaban) Qelaj, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 27 shtator 2024, merr këtë:

VENDIM Nr. 52/2024

Mbi Miratimin për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Sali (Shaban) Qelaj me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik "Formimi i Rrugës në Çarshinë e Gjatë në Pejë në përputhje të plotë me Projektin ideor "Çarshia e Gjatë" – Pejë të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve".

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik "Formimi i Rrugës në Çarshinë e Gjatë në Pejë në përputhje të plotë me Projektin ideor "Çarshia e Gjatë" – Pejë të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve".
- II. Parcela kadastrale nr.936-2 në sipërfaqe prej 33m² ZK Pejë pronë e pronarit Sali Qelaj do të merret për nevoja të përmbushjes së Interesit Publik "Formimi i Rrugës në Çarshinë e Gjatë në Pejë në përputhje të plotë me Projektin ideor "Çarshia e Gjatë" – Pejë të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve" dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.3394-8 në sipërfaqe prej 33m² ZK Pejë pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 12.08.2024.
 - Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.3394-8 në sipërfaqe prej 33m² ZK Pejë është vlerësuar 700.00 €/m², që i bie totali 23,100.00 €.
 - Prona private e Sali Qelaj, ngastra kadastrale nr.936-2 në sipërfaqe prej 33m² ZK Pejë është vlerësuar 700.00 €/m², që i bie totali 23,100.00 €.
 - Pasi që pronat kanë sipërfaqe të njëjtë dhe vlerësimi po ashtu është i njëjtë, palët nuk kanë obligime financiare ndaj njëra tjetrës.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësores-Juridike.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në Web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj

